

PROGRAMI PËR RIMËKËMBJEN E RRËQEBULLIT TË BALLKANIT

Newsletter

ÇËSHTJET KRYESORE:

- Fq. 2- A po e humbim rrëqebullin e Ballkanit?
- Fq. 3- Vetë-reflektim i BLRP - Një rast studimor
- Fq. 4- Munella shpallet zonë e mbrojtur: Një shpallje e vonuar dhe e cinguar
- Fq. 5- Studimi mbi prezencën e rrëqebullit në Jasen, Maqedoni e Veriut
- Fq. 6- Kërcënimet ndaj rrëqebullit të Ballkanit dhe shpresat për rimëkëmbjen e tij në Kosovë



© LL/BLRP

PROGRAMI PËR RIMËKËMBJEN E RRËQEBULLIT TË BALLKANIT: NJË PËRPJEKJE 15 VJEÇARE

Nga Lisa Leschinski

Për 15 vite me rradhë, ekipi i Programit për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit (BLRP) ka punuar për të mbrojtur një nga macet më të fshehta në të gjithë botën, rrëqebullin e Ballkanit (*Lynx lynx balcanicus*). Rrëqebulli i Ballkanit është një nënloj i rrëqebullit EuroAziatik, i rrezikuar në mënyrë kritike, i cili listohet në Aneksin II të Konventës së Bernës, që udhëzon për një mbrojtje më të madhe ndaj këtij nënloji përgjatë vendeve ku shtrihet popullata e tij. Popullata aktuale e rrëqebullit të Ballkanit është e shtrirë përgjatë Brezit të Gjellbël Ballkanik, në rajonin ndërkuftar midis Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, si dhe në zona të tjera të vogla në Shqipërinë veriore, qendrore dhe juglindore, apo në perëndimin e Kosovës. Shtrirja e këtij nënloji është tejet e kufizuar, po njësoj siç është edhe numri i popullatës së tij, e cila përbëhet nga më pak se 50 individë, sipas vlerësimit të studiuesve. Përtej rrezikut të lartë të zhdukjes prej numrit ekstremisht të ulët të popullatës, rrëqebulli i Ballkanit rrezikohet edhe nga gjuetia e paligjshme ndaj vetë atij apo edhe gjahut (kaproll, dhi e egër), si dhe humbja e habitatit për shkak të shpyllëzimit.

Nëpërmjet këtij newsletter-i 6 muor kemi si qëllim të ofrojmë një pasqyrë të punës së bërë nga Programi për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit. Ne synojmë të raportojmë mbi sukseset dhe sfidat me të cilat përballen organizatat e përfshira në këtë program, duke ju shoqëruar nëpër rajonet ku fshihen individë të kësaj maceje mahnitëse. Sidoqoftë, nëse dëshirojmë që kjo mace të na mahnisë edhe në vitet e ardhshme, të gjithë ne duhet të bashkojmë forcat për ta mbrojtur atë së bashku me habitatin, përndryshe thirrja e rrëqebullit të Ballkanit së shpejti nuk do të dëgjohet më!




STUDIM INTENSIV ME KAMERA-KURTH NË RAJON: A PO E HUMBIM RRËQEBULLIN E BALLKANIT?

Nga Manuela von Arx

Studimet me kamera-kurth janë shndërruar në një metodë standarte për numërimin e llojeve të fshehtë. Kjo metodë është tejet efikase veçanërisht për macet me pulla, të cilat mund të identifikohen lehtësisht nga njëra-tjetra, ku bën pjesë edhe rrëqebulli i Ballkanit. Qasja e sugjeruar nga kjo metodë është marrja e evidencave fotografike të një lloji brenda një zone studimore dhe kohe të caktuar. Qëllimi i saj është grumbullimi i informacionit mbi shtrirjen e rrëqebullit të Ballkanit dhe – duke krahasuar fotografitë – vlerësimi i numrit minimal të rrëqebullit në zonat e studiuar. Kur arrihet që të gjenerohen mjaftueshëm fotografi nga individë të ndryshëm, numri i saktë i popullatës mund të llogaritet nëpërmjet metodologjisë “kapje-rikapje”. Që prej vitit 2008, ekipi i BLRP e aplikon këtë strategji çdo dy ose tre vite në Parkun Kombëtar të Mavrovës (Maqedoni e Veriut), një zonë kyç për rrëqebullin e Ballkanit, ndërkohë që në vendet e tjera të shtrirjes (Shqipëri, Kosovë), fokusi është vendosur te identifikimi i numrit minimal të individëve për shkak të pranisë së ulët të këtij lloji.

Nga muaji Shkurt deri në Maj të vitit 2021, 60 kamera-kurth u vendosën në 30 vendndodhje në brendësi të Parkut Kombëtar të Mavrovës (Zona nr. 1 në hartë) duke përdorur të njejtën teknikë që u shpjegua më sipër. Në Shqipëri u vendosën në tërësi 49 kamera-kurth, 29 prej të cilave u instaluan në Malin e Munellës (Nr.2) dhe 20 në Polis-Valamarë (Rajoni i Elbasanit; Nr.3), duke vendosur vetëm një kamerë për secilën vendndodhje të treguar në hartë. Në Kosovë, 23 kamera-kurth u shpërndanë në Parkun Kombëtar të Bjeshkëve të Nëmuna (Nr.4) dhe 19 në Parkun Kombëtar të Sharrit.

Ndërkohë që ky studim tanimë ka përfunduar, rezultatet e marra paraqiten si alarmuese: Në Parkun Kombëtar të Mavrovës, u grumbulluan vetëm 19 fotografi rrëqebulli, një numër tejet i ulët në krahasim me vitin 2018, kur studimi gjeneroi 73 fotografi. Të dhënat tregojnë për katër individë të ndryshëm (2018: 10 individë, sipas përlogaritjeve mendohej se numri mund të shkonte deri në 14).





Në Shqipëri janë marrë 5 foto rrëqebulli në rajonin Polis-Valamarë, prej të cilëve janë identifikuar dy individë të ndryshëm. Në Malin e Munellës u grumbulluan 17 fotografi rrëqebulli. Megjithatë, të dhënat tregojnë vetëm për dy individë të ndryshëm (nga studimet e mëparshme ndodheshin të paktën 4 rrëqebuj në këtë rajon. Në Kosovë, një rrëqebull u fotografua në Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna, ndërkohë që asnjë nuk u fotografua në Parkun Kombëtar të Sharrit.

Ekipit tonë i nevojitet më tepër kohë për të analizuar të gjitha të dhënat, duke përfshirë rastin e disa individëve të rrëqebullit që u fotografuan në Maqedoninë e Veriut, jashtë Parkut Kombëtar të Mavrovës. Gjithsesi, rezultatet e deritanishme na bëjnë të jemi tejet të shqetësuar për situatën e rrëqebullit të Ballkanit.

VETË-REFLEKTIM I BLRP - NJË RAST STUDIMOR

Fondacioni MAVA së bashku me FOS Europe dhe CCNet Europe përfshinë Programin për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit në materiale studimore si një shembull për projektet e konservimit që kanë kaluar një cikël të plotë (rishikimi dhe vlerësimi i aktiviteteve të kaluara dhe planifikimi i atyre të ardhshme) duke përdorur Standartet e Ruajtjes. Si rezultat, FOS Europe përpunoi dhe publikoi dokumentin “Vetë-reflektimi: një teknikë frytdhënëse për vlerësimin e impaktit”, ku BLRP listohet si një rast studimor:

<https://mava-foundation.org/blog-self-evaluation-a-powerful-tool-for-evaluating-impact/>

Self-evaluation

A POWERFUL TOOL FOR IMPROVING CONSERVATION IMPACT

True impact in conservation is not achieved by scoring achievements and writing success stories, but by critically assessing effectiveness and adapting strategies accordingly.

By relying on a process of genuine self-reflection, the MAVA Foundation helps its grantees boost their effectiveness and strengthen the partnership of collaborating teams. As grantees can rest assured of continued funding independently of the evaluation outcome, they have a safe space to draw their own conclusions.

MAVA strongly believes in this approach of approving funding and asking for internal evaluation, as it leads to transparent communication with grantees and the assurance that the grant is used in the best way possible. The approach provides a way of simultaneously evaluating and improving the impact of the conservation projects MAVA funds.



A self-evaluation story

In 2016, after ten years of dedicated conservation work by the Balkan Lynx Recovery Programme, MAVA asked the team to undergo an internal evaluation process, in order to understand the achievements and impact of their work and to bring this understanding into the design of the next programme phase. MAVA had granted the follow-up funding for the next programme period irrespective of the evaluation results. Thanks to this, the team was free to perform a truly transparent review. In the role of external facilitator, FOS Europe provided methodological and process guidance, navigating the team through the self-evaluation process described on the next page.

The Balkan Lynx Recovery Programme (BLRP)

is a transboundary conservation programme, working to recover a viable population of the critically endangered Balkan Lynx (*Lynx lynx balcanicus*). It is implemented by a partnership of NGOs:

- Protection and Preservation of Natural Environment in Albania (PPNEA)
- Macedonian Ecological Society (MES), North Macedonia
- Environmentally Responsible Action Group (ERA), Kosovo
- KORA (Carnivore Ecology and Wildlife Management), Switzerland
- EuroNatur, Germany

... in collaboration with Center for Protection and Research of Birds of Montenegro (CZIP) and Finch from Kosovo between 2013 and 2018. The BLRP has received funding from the MAVA Foundation since its beginning in 2006.

Photo © PPNEA

MUNELLA SHPALLET ZONË E MBROJTUR: NJË SHPALLJE E VONUAR DHE E CUNGUAR

Nga Bledi Hoxha dhe Klejn Ngraçani

Shpallja e Malit të Munellës si një zonë e mbrojtur ka hasur shumë vështirësi gjatë këtyre viteve. Megjithatë, ekipi i PPNEA për rrëqebullin e Ballkanit ka qenë gjithmonë i vendosur për të siguruar strehën kryesore të këtij nënlloji në Shqipëri.

Në vitin 2011 PPNEA fotografoi për herë të parë rrëqebullin e Ballkanit në Shqipëri pikërisht në Malin e Munellës, një moment që shënjoi nisjen e përpjekjeve shumëvjeçare për ruajtjen e këtij nënlloji të rrezikuar. Pas marrjes së kësaj fotografie, PPNEA filloi të mblidhte të dhëna për shtrirjen e rrëqebullit në rajon. Në vitin 2015, studimet të njëpasnjëshme me kamera-kurth zbuluan një popullatë të vogël prej 4-5 individësh në rajonin e Munellës, çfarë e bëri të qartë që e gjithë zona duhej të fitonte një status të mbrojtur.

Menjëherë pas këtij zbulimi, PPNEA përgatiti Raportin e Vlerësimit të Biodiversitetit për rajonin e Malit të Munellës, ku përfshihen edhe arsyet për mbrojtjen e tij, një dokument tejet i nevojshëm për të filluar procesin e shpalljes së Malit të Munellës si një zonë e mbrojtur. Dokumenti në fjalë u prezantua në shumë evente lobuese në prani të autoriteteve qendrore dhe vendore. Akoma më tej, raporti u përfshi edhe në propozimin zyrtar të dërguar nga PPNEA në vitin 2018 pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

Në vitin 2020 autoritetet shqiptare filluan procesin e rishikimit të rrjetit kombëtar të zonave të mbrojtura. Ishte një kënaqësi e veçantë për ekipin e PPNEA të shikonte Malin e Munellës të listuar në zonat e reja të propozuara për marrjen e një statusi të mbrojtur. Ajo që fillimisht u duk si një sukses, në dhjetor 2020 u shndërrua në një sukses gjysmak. Në ligjin e propozuar “Për Miratimin e Kufijve të Zonave të Mbrojtura”, vetëm 20.668 hektarë nga 51.929 që kishte propozuar PPNEA u shpallën si zonë e mbrojtur, nën kategorinë IV (Rezervë Natyrore e Menaxhuar/Park Natyror) sipas Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës, në vend të kategorisë II (Park Kombëtar) që u propozua fillimisht nga PPNEA.

Mungesa e vullnetit politik, numri i ulët i ekspertëve të përfshirë në procesin e rishikimit të zonave të mbrojtura, si dhe afati kohor i limituar që zgjati rreth një vit, solli rezultatet e mësipërme. Duke qenë se rrëqebulli i Ballkanit është një nënlloj që mbulon një territor të gjerë, ekspertët e PPNEA dhe BLRP janë të mendimit se 20.668 hektarë nuk janë mjaftueshëm për të siguruar mbrojtjen dhe rimëkëmbjen e kësaj popullate në rajonin e Munellës.



NJË UDHËTIM NË NATYRËN E PACËNUAR: STUDIMI MBI PREZENCËN E RRËQEBULLIT NË JASEN, MAQEDONI E VERIUT

Nga Aleksandar Pavlov dhe Aleksandar Stojanov



© MES/BLRP

Në vjeshtën e vitit 2020 një projekt i ri për rrëqebullin e Ballkanit filloi në zonën e mbrojtur Jasen në Maqedoninë e Veriut, Kategoria VI (Zonë Multifunkionale). Ky projekt i financuar nga UNDP, i titulluar “Ris Jasen” (Rrëqebull Jasen), u implementua nga Shoqëria Ekologjike Maqedonase (MES) në bashkëpunim me autoritetet menaxhuese të zonës. Ashtu siç ishte menduar, ky projekt kërkimor grumbulloi të dhëna tepër interesante për përhapjen e rrëqebullit në këtë zonë pak të vizituar!

MES ka ndërmarrë edhe gjatë viteve të kaluara kërkime të ngjashme në zonë, megjithëse me intensitet dhe kohëzgjatje të ndryshme. Studimi i parë me kamera-kurth në Jasen u implementua në periudhën 2010-2011, ku u grumbulluan dy foto të rrëqebullit të Ballkanit. Gjatë kësaj periudhe ekipi i MES instaloi edhe një kuti kurth, e cila fatkeqësisht nuk rezultoi të ishte e suksesshme.

Studimi i dytë me kamera-kurth u realizua në vitin 2014, por fatkeqësisht nuk mundësoi asnjë foto rrëqebulli. Në periudhën që vijoi (2014-2016), në këtë zonë u vendosën përsëri disa kamera-kurth, të cilat arritën të fotografojnë vetëm një rrëqebull në vitin 2014.

Studimi i fundit i realizuar në këtë zonë u nxit më së shumti nga marrja e disa fotografive të rrëqebullit të Ballkanit pas vitit 2016, të cilat tregojnë për një popullatë të qëndrueshme në Jasen.

Ky studim i fundit për rrëqebullin e Ballkanit në zonën e mbrojtur të Jasenit u implementua nga muaji Nëntor i vitit 2020 deri në Qershor të vitit 2021, duke përdorur metodat e kamerave-kurth dhe kutisë-kurth. 20 kamera kurth u vendosën në 20 vendndodhje të ndryshme në zonë, ndërkohë që dy kutitë kurth u vendosën në 3 vendndodhje të ndryshme (një kuti-kurth mbuloi dy zona njëra pas tjetrës). Studimi me kamera-kurth përfundoi me 24 fotografi rrëqebulli nga 8 vendndodhje të ndryshme. Krahasimet vizuale zbuluan praninë e të paktën 3 individëve. Dy prej këtyre individëve u kapën nëpërmjet kutive kurth. Individu mashkull (Noni) u kap më 21 Shkurt, ndërkohë që individ femër (Nela) u kap më 29 Mars. Të dy këta rrëqebuj u pajisën me kollare GPS/GSM, në mënyrë që të studiohej lëvizja e tyre. Të dhënat e grumbulluara nëpërmjet GPS-it hodhën dritë mbi lëvizjet kureshtarë të këtyre dy individëve në habitatet e tyre, si zotërimi i një zone mjaft të madhe, kalimi me not në liqenin Kojzak në Jasen, si dhe kalime shkurtra në Malin Vodno pranë qytetit të Shkupit.

Ky projekt ishte i suksesshëm edhe për vendosjen e një bashkëpunimi midis MES dhe rojeve mjedisore nga Jaseni. Përveç kamerave të vendosura nga MES edhe rojet mjedisore instaluan kamerat e tyre në zonë, duke grumbulluar foto të tjera rrëqebulli apo informacion shtesë mbi praninë e tij.



© MES/BLRP

KËRCËNIMET NDAJ RRËQEBULLIT TË BALLKANIT DHE SHPRESAT PËR RIMËKËMBJEN E TIJ NË KOSOVË

Nga Bardh Sanaja

Gjuetia e paligjshme dhe zhvillimet infrastrukturore janë disa nga aktivitetet që po e shtyjnë rrëqebullin e Ballkanit drejt zhdukjes. Në vitin 2021, gjuetia e paligjshme u shndërrua në problemin më të madh në zonën e Bjeshkëve të Nëmuna, për arsye se shoqatat e gjuetarëve morën lirinë për të lejuar aktivitetin e gjuetisë brenda zonës së mbrojtur, edhe pse ligjërish të kanë të pamundur. Për të kundërshtuar këtë veprim, ERA e adresoi çështjen drejt Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Brendshme, të cilat i drejtuan një letër zyrtare shoqatave të gjuetarëve duke pohuar se aktiviteti i tyre brenda zonës së mbrojtur ishte i paligjshëm. Megjithatë, rezultatet në terren të këtij veprimi mbeten për tu parë.

Një tjetër zhvillim interesant në Kosovë është ndërprerja e ndërtimit të rrugës Lumëbardh – Milishevc pas katër vitesh përpjekje, e cila ishte planifikuar të ndërtohej në brendësi të zonës strikte në Bjeshkët e Nëmuna. Ky rast u ndërpre mbi argumentet e një problemi në proceset e prokurimit dhe mungesës së ligjshmërisë.



Në mënyrë që të mbështetet monitorimi dhe përpjekjet ruajtëse për rrëqebullin e Ballkanit dhe jetës së egër në Kosovë, nevojitet një bashkëpunim eficient midis organizatës ERA dhe autoriteteve shtetërore. ERA arriti të organizojë një mbledhje me përfaqësuesit e qeverisë së re brenda Ministrisë së Mjedisit, lidhur me krijimin e një Koncepti të ri Kombëtar Monitorimi. Qëllimi i këtij takimi ishte zhvillimi i një koncepti mbi mbledhjen e të dhënave për jetën e egër, si p.sh. rrëqebullin e Ballkanit. ERA dhe Ministria e Mjedisit në Kosovë janë duke planifikuar firmosjen e një marrëveshje mbi hapat e ardhshëm që duhen ndërmarrë për të finalizuar iniciativën e sipërpërmendur.



PROGRAMI PËR RIMËKËMBJEN E RRËQEBULLIT TË BALLKANIT

Balkan Lynx Recovery Programme (BLRP)

“Programi për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit” (BLRP) është një iniciativë e përbashkët që implementohet nga Fondacioni EuroNatur, KORA (Shoqata e Ekologjisë së Mishngrënësve dhe Menaxhimi i Jetës së Egër në Zvicër), MES (Shoqëria Ekologjike Maqedonase), PPNEA (Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri) dhe ERA (Grupi i Veprimit me Përgjegjësi Mjedisore).

Informacion shtesë:

<https://www.facebook.com/balkanlynx>

Programi për Rimëkëmbjen e Rrëqebullit të Ballkanit mbështetet financiarisht nga Fondacioni MAVa, me seli qendrore në Zvicër.



Environmentally
Responsible
Action



PPNEA

Protection and Preservation of Natural Environment in Albania



MACEDONIAN
ECOLOGICAL
SOCIETY



Mbështetur nga:

euRONATUR

